

V E N D I M

Nr. 6, Datë 10.04.2015

MBI DISKUTIMET DHE PROPOZIMET NË LIDHJE ME PROJEKTLIGJIN "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" TË MIRATUAR NË KËSHILLIN E MINISTRAVE

Senati Akademik i Universiteti të Arteve u mbledh në datën 10.04.2015 dhe diskutoi mbi projektligjin "Për arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë". Pas diskutimeve të të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe mendimeve të marra nga strukturat e tjera të Universitetit të Arteve, u arrit në konkluzionet e mëposhtme:

Në Draftin e fundit të paraqitur nga Komisioni i hartimit të ligjit të Arsimit të lartë përcaktoheshin disa elemente bazë për zhvillimin dhe standardet e IAL-ve me specifikë të veçantë. Por në projektligjin e kaluar në qeveri Universitetet me status të veçantë nuk e gëzojnë më këtë status. Ato mbeten në varësi të vendimeve të Këshillit të Ministrave. Ne mendojmë se në këtë projektligj, duhej të përcaktoheshin qartë elementet bazë të cilat e drejtonin një Universitet drejt fitimit të këtij statusi. Në të vërtetë kjo e drejtë është lënë të përcaktohet vetëm me VKM, ku do të vendoset se kush e meriton këtë status e kush jo. Për një institucion të arsimit të lartë si Universiteti i Arteve, ky përcaktim nuk mund të mbetet pjesë e një VKM-je por e një përcaktimi të saktë të saj në ligj. Ne vazhdojmë të këmbëngulim se "IAL/Degë me natyrë të veçantë" duhet të gjejnë vendin e duhur në këtë projektligj.

Në të gjitha draftet e paraqitura deri tani në kreun "ORGANIZIMI I STUDIMEVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË" ka qenë i vendosur qartë një nen i tillë:

Programet e studimit në fushën e arteve dhe sporteve

Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe fiancimi nga Buxheti i Shtetit i institucioneve të arsimit të lartë, që ofrojnë këto programe



studimi bëhet në përputhje me këtë ligj dhe specifikave përkatëse të përcaktuara me akte nenligjore të Ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Në projektin përfundimtar ky nen nuk ekziston më! Ne bëjmë pyetjen; PSE? Ky ishte i vetmi nen që sanksiononte qartë të veçantën e një shkolle arti. Si ka mundësi që tjetër gjë miratojmë kur i diskutojmë bashkë e tjetër gjë paraqitet në qeveri! Ne përsëri kërkojmë që ky nen duhet të jetë i qartë, i specifikuar dhe i vendosur në ligj. Një rregullim i tillë shërben edhe për shmangien e një numri problemesh specifike që dalin në nene të tjera të projektligjit, disa prej të cilave referohen më poshtë.

Neni 45 pika 2.

Komisionet e përhershme

Në gjashtë pikat e këtij neni flitet për ngritjen dhe funksionimin e disa komisioneve të përhershme. Por ne na lind një pyetje: A do të paguhen këta anëtarë të këtyre komisioneve ?

Nga cili fond do të paguhen këto komisione që tashmë nuk janë dhe të pakët?! Aktualisht në UAR për vetë mundësitë buxhetore që ka me shumë vështirësi po arrihet të paguhen anëtarët e Senatit, anëtarët e Këshillave të Fakulteteve dhe anëtarët e Këshillit të Administrimit ! Po për gjithë ata anëtarë të këtyre komisioneve që do të jenë nesër, çfarë zgjidhje do të ketë?

Neni 47 pika 2.

Përbërja dhe krijimi i Bordit të Administrimit

Përbërja e Bordit të Administrimit përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit publik të arsimit të lartë, të miratuar nga Bordi i Administrimit. Ja çfarë thotë neni 47 në pikën 2;

Nëse institucioni siguron vetë pesëdhjetë përqind ose më shumë të buxhetit afatmesëm, katër prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe tre janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur institucioni siguron vetë më pak se pesëdhjetë përqind të buxhetit afatmesëm, tre prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së, dhe katër janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Në rastet kur njësisia e qeverisjes vendore në territorin e së cilës zhvillon veprimtarinë institucioni i arsimit të lartë kontribuon financiarisht, së paku në masën prej dhjetë përqind të buxhetit afatmesëm të IAL-së, atëherë një



prej përfaqësuesve që i takon ministrisë përgjegjëse për arsimin, përcaktohet nga njësia e qeverisjes vendore.

UART si dhe universitete të tjera, e ka kundërshtuar gjithmonë këtë nen duke e argumentuar me autonominë universitare. Universiteti i Arteve nuk e ka të mundur të sigurojë vetë 50 % të buxhetit. Kështu siç paraqitet ky nen Universiteti i Arteve për vetë specifikat që mbart si; numrin e pakët të studentëve, koston e lartë të studimeve, numrin e madh të pedagogëve të ftuar etj, asnjëherë nuk do të ketë të drejtën të vendosë vetë për asgjë. Në asnjë vend tjetër nuk ndodh që një shkollë e lartë e artit si e jona të mund të sigurojë vetë 50% të buxhetit. Kjo për shumë arsye të cilat i kemi bërë të qarta në vazhdimësi e ku disa prej tyre i prekëm edhe këtu. Dikush mund të mendojë dhe të thotë se: Po, kështu është, shteti të financon dhe shteti do të vendosë për ju!!! Na lejoni t'Ju pyesim edhe ne:

Po Universiteti i Arteve i kujt është ? A nuk është një e mirë dhe aset i shqërisë shqiptare? Pedagogët e studentët të kujt janë ?

Nëse ky nen do të qëndrojë kështu siç është atëherë le të mos flasim për autonomi institucionale, sepse kjo nuk mund të jetë në këtë mënyrë. Ne kemi propozuar e vazhdojmë të jemi të mendimit që **raporti të jetë në të gjitha rastet 4 (katër) anëtarë nga IAL-të, dhe 3 (tre) përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin.**

Për më tepër, nuk përcaktohet as procedura se si do të ndodhë zëvendësimi i një anëtari të bordit duke kaluar në favor të ministrit të arsimit. Nuk përcaktohet nëse referenca në buxhetin afatmesëm bëhet për buxhetin e planifikuar apo për buxhetin faktik (kur? Në përfundim të periudhës 3-vjeçare të buxhetit afatmesëm?), apo do të merret në konsideratë planifikimi dhe realizimi vjetor i buxhetit afatmesëm. Nga ana tjetër buxheti afatmesëm nuk përbën tregues të qëndrueshëm tek i cili të bëhet referencë.

Neni 48 **Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë**

pika gj. *miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;*

Ne nuk e shikojmë të arsyeshme që miratimi i statudit të institucionit të miratohet dy herë. Ky veprim jo vetëm që e dëmton pavarësinë institucionale por krijon njëherazi dualizimin e saj.



Ne propozojmë për këtë pikë të jetë;

Bordi i Administrimit jep mendimin ose shprehet për statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet për miratim Senatit Akademik; mund të pranohet vendimi i Bordit të Administrimit për dispozitat e statutit që lidhen specifikisht me çështje të administrimit.

Neni 129 Statuti dhe rregullorja e institucioneve të arsimit të lartë

Pika 2. Ministria përgjegjëse për arsimin, para përfundimit të mandatit të autoriteteve dhe organeve ekzistuese në IAL publike, miraton rregulloren për zgjedhjet e para, sipas këtij ligji, të autoriteteve dhe organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë publik. Rregullorja përcakton kriteret për hartimin e listave zgjedhore, regjistrimin e kandidatëve, procesin e votimit, kriteret e vlefshmërisë e të numërimit të votave, rregullat për shpalljen e rezultatit dhe të fituesve, procesin dhe afatet e ankimimit.

Përse duhet t'a miratojë Ministria e Arsimit dhe Sportit Rregulloren e Zgjedhjeve? Kjo ka qenë e drejtë e Senateve Akademike, pra e vetë Universiteteve. Ku qëndron autonomia ??

Ne kërkojmë që rregullorja e zgjedhjeve të miratohet nga senatet akademikë të universiteteve.

Po ashtu dëshirojmë të shprehim mendimin tonë për **Kapitullin 12,**

Institucioni Publik i Pavarur i Arsimit të Lartë.

Ky kapitull për mendimin tonë përbën një strukturë e cila nuk shkon në dobi të universiteteve publike. Ky kapitull ka hapur shumë debate dhe ne mendojmë se rishikimi i tij do të rrisë kredibilitetin e universiteteve publike

te cilët bazohen te automomia e jo te e drejta e individëve të veçantë mbi këto universitete, siç parashikohet ne projektligj.

Duke e vlerësuar si një moment shumë të rëndësishëm analizën dhe debatin që Ju të nderuar deputetë do t'i bëni këtij projektligji, ngelemi të hapur ndaj çdo mundësie që mund të na jepni për t'u dëgjuar nga ju e për të arritur sëbashku në një ligj bashkëkohor e të dobishëm për arsimin e lartë shqiptar.

Ju faleminderit,



Senati i Universitetit të Arteve

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Gazmend LEKA

Prof. Hajg ZACHARIAN

Prof. Milto KUTALI

Prof. Asoc. Artan PEQINI

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI PRELA

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Astrit SELITA

Prof. Idir MARTINI

Enisa VRENOZAJ

Albjan VUKAJ

Elia PLAKU

Miranda BAKIASI

Ramazan GURRA

Kristina AGO